

I dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e një anëtari të policisë “Alfa”. Almir Drlanjin i dorëzohet autoriteteve maqedonase sot pasdite nga autoritet Kosovare, pas arrestimit të tij në Ferizaj në 2012.

Alimir Drlanjin nga gjykata maqedonase është i dyshuar për krime të rënda dhe se policia maqedonase e cilëson si një nga kriminelët më të rrezikshëm e vendit.

Ndryshe më 26 nëntor të vitit 2008, tre shqiptarët nga Shkupi dhe Kumanova, ish-pjesëtarë të UÇK-së ishin të dënuarit me burgim të përjetshëm të cilët u akuzuan për vrasjen e një pjesëtari të njësitit policor “Alfa” në Shkup, njofton TetovaSot.

Rexhail Qerimi (41) nga fshati Opajë i Kumanovës, Agim Islami (27) nga fshati Rashçe të Shkupit, dhe Almir Drlanjin (31) nga Shkupi më 30 prill 2010 u dënuan me burgim të përjetshëm, ndërsa Ramadan Shaqiri, i akuzuari i katërt për dhënien e ndihmës është akuzuar me gjashtë vite burg./TetovaSot/